**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

**C-IV-13-3052**

*Parashtruesi i Ankesës*

**M S** Jagodinë, Serbi

***kundër***

*Pala kundërshtare*

**Agjencioni Kosovar i Privatizimit-** AKP, (**NSH "K"** Pejë) Rr. "Agim Rramadani" 23 Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 17 nëntor 2020, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

1. **Ankesa hudhet si e papranueshme.**

2. **Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

**<u>Rrethanat faktike dhe procedurale</u>**

Me 13 nëntor 2013, ankuesja parashtroj një ankesë, të panëshkruar, kundër listës së publikuar të punëtorëve të NSH "K" Pejë, për përfitimin e një pjese të hyrave prej 20% nga privatizimi i NSH.

Ankuesja pohon se pranë NSH ka punuar nga 22 gusht 1998 e gjer me 10 qershor 1999, kur për arsye të sigurisë është larguar nga vendbanimi dhe vendi i punës.

Ankuesja kërkon përfshfirjen e saj në listë si dhe të drejtën e saj në 20% nga shuma e privatizimit dhe likuidimit të NSH.

Ankesës i është bashkangjitur:

- Kopja e Librezës së Punës, për ankuesen.

Me 31 mars 2014, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesen dhe ju kërkua që të parashtroj si në vijim

a. kopjen e autorizimit për përfaqësuesin e saj i cili duhet të jetë anëtar i Odës së Avokatëve,
b. kopjen e vendimit ndaj së cilës është ushtruar ankesa,
c. kopjen e nënshkruar të ankesës pasi që ankesa e dorëzuar ishte e panënshkruar, dhe
d. dëshmi dhe prova shtesë si dëshmi mbi pretendimet e saj ankimore.

Ankuesja pranoj urdhërin me 23 prill 2014.

Ankuesja nuk e ka përmbushur urdhërin.

AKP me 27 tetor 2018 parashtroj përgjigjen.

AKP ankesën e ankueses e konsideroj si të pabazuar. AKP pohoj se ankesa, lidhur me listën e 20% të punëtorëve të cilët kanë përfituar nga privatizimi i NSH, se është parashtruar jashtë afatit. AKP mëtutje pohoj se afati përfundimtar mbi parashtrimin e ankesave, pranë DHPGJS, ishte data 14 janar 2012 gjersa ankesa është parashtruar me 13 janar 2013. Nga gjitha arsyet, AKP propozoj që ankesa të hedhet si e papranushme ose refuzohet si e pabazuar.

Përgjigja e AKP ju dorëzuar ankueses me 27 nëntor 2018.

Ankuesja nuk ka parashtruar përgjigje.

Me 16 tetor 2020, gjykata lëshoj një urdhër të dytë për ankuesen me të cilin ju kërkuar që të parashtroj kopjen e vendimit të autoritetit të likuidimit ndaj së cilës është ushtruar ankesa.

Me parashtresën e parashtruar me 30 tetor 2020, ankuesja mbeti pranë ankesës. Me këtë parashtresë ankuesja parashtroj kopjen e kërkesës kreditore e parashtruar pranë AKP me 19 maj 2007, një kopje të deklaratës së dhënë nga ankuesja dhe kopjen e përgjigjes së AKP në dy gjuhët.

**<u>Arsyetimi ligjor:</u>**

Ankesa konsiderohet e papranueshme.

Ankuesja kërkon përfshirjen në listën e punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën në 20% nga privatizimi-likuidimi i NSH "K" Pejë ( emërtimi i mëvonshëm si rezultat i transformimit SHPK "K").

Sipas nenit 10.6 paragrafi (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime duhet të dorëzohet në DHPGJS brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare.

Nga lista e publikuar, shihet se afati për parashtrimin e ankesave, ishte gjer me datën 14 janar 2012 gjersa ankuesja ka parashtruar ankesë me 13 janar 2013, çka do të thotë 1 vjet pas publikimit të listës përfundimtare.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

*<u>Ndër të tjerash ( obiter dictum)</u>*

Edhe pse kjo pjesë nuk është çështje e këtij vendimi, ankuesja me ankesë gjithashtu pohon edhe të drejtën e saj nga likuidimi i NSH.

Ankuesja duke vepruar sipas urdhërit të gjykatës, me parashtresën e datës 30 tetor 2020 ka parashtruar kopjen e kërkesës së saj kreditore, në shumë prej 15,000 Euro, të parashtruar pranë AKP, por nuk ka parashtruar kopjen e kërkuar të vendimit të autoritetit të likuidimit.

Sipas nenit 36 paragrafi 2.6 i Ligjit për DHPGJS parasheh se një padi/ankesë konsiderohet e pranushme nëse është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa.

Edhe përkundër tentimeve të gjykatës, me anë të urdhëresave, ankuesi nuk e ka përmbushur urdhërin.

**Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 13.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e taksave gjyqësore, punëtorët lirohen nga pagesa e taksave.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit të DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

**Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

_____

Gazmend Sylaj, Gjyqtar